

Arrestohen dy të dyshuar, konfiskohen disa armë



Foto ilustrim

Policia e Kosovës ka arrestuar dy të dyshuar për përfshirje në vepra penale, ndërsa gjatë bastisjes së një shtëpi, ka konfiskuar disa armë dhe materiaile tjera.

“Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotik, Njësia e Mitrovicës-Veri, pas një pune paraprake hetimore, më 14.02.2019, ka zbatuar një urdhër-kontrolli të lëshuar nga Gjykata Themelore-Mitrovicë, e cila ka rezultuar me arrestimin e dy personave të dyshuar: S.H. viti i lindjes 1968, m, k, sh dhe B.H. viti i lindjes 1971 m, k, sh”, thuhet në njoftimin e Policisë.

Kontrolli policor është realizuar në dy shtëpi banimi dhe lokale përcjellëse të të dyshuarve me ç'rast në cilësi të provave materiale janë konfiskuar armë dhe municion të kalibrit të ndryshëm:

katër pistoleta,

një elektroshok,

dyqind e tetëmbëdhjetë (218) copë fishekë,

këllëf i lëkurës për mbajtje te pistoletës,

një anti-plumb ushtarak,

dy telefona celular etj.

Me urdhër të prokurorit kompetent, i dyshuari B.H. është ndaluar në mbajtje për 48 orë, kurse i dyshuari S.H. është liruar në procedurë të rregullt.

Vido-linku i operacionit policor: